

Lënda: Informacion për publikun për zbatimin e Ligjit Nr 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”

Kërkesat për informim nga Ministria e Punëve të Jashtme do të pranohen nga kërkuesit në formë elektronike duke paraqitur saktë indentitetin dhe nënshkrimin tij si dhe me shkrim duke e dërguar dorazi ose me postë.

Kërkesa për informim duhet të përmbajë:

- a) emrin dhe mbiemrin e kërkuesit;
- b) adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni;
- c) përshkrimin e informacionit që kërkohet;
- ç) formatin në të cilin preferohet informacioni;
- d) çdo të dhënë që kërkuesi gjykon se mund të ndihmojë në indentifikimin e informacionit të kërkuar.

Kërkesa shoqërohet me fotokopje të kartës së indentitetit dhe adresën ku kërkuesi dëshiron të marrë përgjigjen me shkrim në rrugë zyrtare. Për të sqaruar paqartësi që mund të lindin gjatë shqyrtimit të kërkesës, qytetari shënon numrin e celularit ose adresën elektronike.

Kërkesat për legalizimin e dokumentave dhe shfrytëzimin e arkivit historik të Ministrisë do t’iu përgjigjemi sipas informacionit të publikuar në faqen zyrtare të MPJ.

Në këndin e Informimit të Publikut janë të ekspozuara formatet tip të miratuara nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për:

- 1.Kërkesa për informacion
- 2.Informacion për dokumentacionin e kërkuar
- 3.Refuzimin e formës së kërkuar të informacionit/dokumentacionit
- 4.Për zgjatjen e afatit të kthimit të përgjigjes
- 5.Njoftim për fillimin e procedurës për rishikim të dokumentacionit të klasifikuar dhe shtyrje të afatit.

Tarifat për çdo shërbim që ofrohet nga Ministria e Punëve të Jashtme janë si më poshte:

1.Për studiuesit efektiv dhe jo efektiv të Akademisë së Shkencave apo Universiteteve që punojnë për kërkime arkivale:

1 deri në 100 faqe fotokopje 35 lekë për faqe

Mbi 100 faqe fotokopje 50 lekë për faqe

Për personat e tjerë që bëjnë studime të ndryshme , tarifa do të jetë 50 lekë për 1 faqe fotokopje.

2.Për studiuesit e huaj tarifat do jenë:

1 deri në 100 faqe fotokopje, 100 lekë për 1 faqe

Mbi 100 faqe , 200 lekë për faqe.

3.Për skanimin e dokumentave tarifa do jetë 250 lekë për 1 faqe.

Për shërbimet e tjera tarifat do të jenë ato që do të miratohen nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave.

Sekretari Përgjithshëm

Qirjako QIRKO